



# LETËR POZICIONIMI

## mbi

### Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Rrjeti Shqiptar i Zhvillimit Rural  
Nëntor 2018

*Kjo Letër Pozicionimi është përgatitur nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në konsultim të vazhdueshëm me organizatat anëtare të saj, ekspertë dhe studiues të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Cështjet e trajtuara janë konsultuar gjerësisht me fermerë, grupe prodhuesish, OSHC-të, sipërmarrës rural etj. në forumet e Drinit, Arbërit, Vjosës dhe Egnatias të cilat përfaqësojnë bërthamëza rajonale të ANRD.*

*Përgatitja e Letrës së Pozicionimit është nxitur nga shqetësimet e fermerëve dhe sipërmarrësve rural rreth sfidave të shumta që ndeshin për të siguruar ndihmë dhe mbështetje komplementare publike të aktiviteteve të tyre ekonomike.*

*Letra e Pozicionimit përfaqëson një përpjekje për të trajtuar disa nga sfidat kryesore dhe ofrimin e rekomandimeve për adresimin e barrierave që pengojnë programet dhe instrumentet publike mbështetës të sektorit të jenë efektive për të dhënë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në kohë.*

### *Zhvillimet në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në persepektivën e aktorëve jo-publik*

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural synon të kontribuojë në zhvillimin e komuniteteve rurale duke marrë një rol aktiv në proceset dhe reformat e sektorit të zhvillimit rural. Përpyekjet e derimëtanishme kanë reflektuar gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në zbatimin me sukses të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit rural. Në këtë kontekst, ANRD ka nxitur ndërtimin e një agjende aktive, gjithëpërfshirëse dhe me dy kahe të zhvillimit rural në vend.

Zhvillimi i bujqësisë dhe ekonomisë rurale ka qenë një çështje e rëndësishme e politikës së viteve të fundit. Nisma dhe aksione konkrete për të mbështetur dhe nxitur më tej sipërmarrjen private në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural kanë qenë njëherësh sinjale dhe arritje për relevancën e sektorit. Promovimi i risive në skemën kombëtare mbështetëse dhe modeleve zhvillimore të Programit të 100 fshatrave përgjithësisht injektuan një ndjenjë optimizmi në publikun e gjerë dhe në veçanti në banorët e komuniteteve rurale. Kjo në një kohë kur IPARD çel thirrjet e para të projekteve.

Megjithatë, pavarësisht optimizmit të menjëhershëm që rezultatet afat-shkurta krijojnë, ato duhet të kenë në të njëjtën kohë aftësinë për të gjeneruar efekte afat-gjata në ekonominë rurale. Për të qenë të tilla, planifikimi i instrumenteve mbështetës të sektorit duhet të bazohet në evidenca, të integrojnë mësimet e nxjerra nga përvoja të mëparshme, të lidhen ngushtë me burimet ekzistuese dhe potencialet e sektorit, si dhe të kontribuojnë në arritjen e një vizioni të qartë për të ardhmen e tij. Informimi publik dhe transparenca ndërkohë duhet të jenë në themel të çfarëdo mbështetje dhe incentivi publik për sektorin. Ndërsa, ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve mbetet sfida e sektorit.

### *Qëllimi i letrës së pozicionimit dhe fokusi i procesit konsultues*

Duke vlerësuar politikat dhe instrumentat mbështetës të sektorit, synojmë të sjellim një perspektivë kritike të tyre si një mënyrë për të përmirësuar qasjet dhe metodologjinë e hartimit, rishikimit dhe zbatimit të tyre për të marrë efekte afat-gjata në zhvillimin e fshatit shqiptar.

Në këtë kontekst, procesi konsultues mbarëkombëtar i lidhur ngushtësisht me parimet e instrumentit të politikës së BE për zhvillimin rural - Zhvillimit Vendor të udhëhequr nga Komuniteti (CLLD), si një formë e re e zhvillimit të zonave rurale dhe demokracisë me pjesëmarrje – është përdorur për të vlerësuar instrumentet për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri dhe identifikimin e mundësive për përshtatjen më të mirë të tyre me nevojat e komuniteteve rurale duke patur në fokus në të njëjtën kohë procesin e përafrimit me PPB të BE. Kjo sipërmarrje konsultuese është ndërmarrë për t'i ardhur në ndihmë hartimit, rishikimit dhe zbatimit të instrumentave mbështetës të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Kjo letër pozicionimi ka në fokus instrumentet e mëposhtëm: 1. Skemat kombëtare të Mbështetjes së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2018; 2. Programi i 100 fshatrave; 3. Programi për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, IPARD.

1

*A janë skemat kombëtare të mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural efektive? A i përgjigjen ato nevojave reale të fermerëve, sipërmarrësve rurale dhe aktorëve të tjerë? A përmbushin këto skema pritshmëritë për mbështetje dhe orientim të fermerëve, sipërmarrësve rural dhe aktorëve të tjerë? A ndikojnë ekonominë rurale në mënyrë të qëndrueshme?*

Për orientim të mirë të fermerëve dhe grupeve të tjera përfituese në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nevojitet qëndrueshmëri më e lartë në strukturën e skemave të mbështetjes buxhetore ndër vite si në numër masash ashtu edhe në përmbajtje e kriteret. Ndërsa, ka nevojë që masat mbështetëse të përshtaten me specifikat e territoreve rurale të vendit për të qenë kontribuese në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal. Për këtë, formuluesit duhet të mbështeten në studime dhe konsultime të gjera me grupet e interesit si dhe hartimi dhe zbatimi i skemave të shoqërohet me vlerësime për efikasitetin e tyre. Studimet duhet të përfshijnë edhe çështjen e çmimeve dhe koston e inputeve si një mënyrë për të përcaktuar nivele inkurajuese të përfitimit financiar bazuar në çmime reale të tregut. Cikli i skemave duhet të përputhet me ciklin e aktivitetit bujqësor e blegtoral, veçanërisht për ato masa të lidhura me mbështetjen e prodhimit. Risitë e procesit të aplikimit duhet të promovohen të sigurt dhe kjo kërkon që infrastruktura të jetë ndërtuar më parë se ato të ndahen me përfituesit final. Problemet që lidhen me pronësinë e tokës, dhe regjistrimin e saj duhet të jenë çështje prioritare të Qeverisë si parakushte për investimet në zhvillimin rural dhe jo vetëm të mbështetura nga skemat kombëtare.

2

*A janë hartuar dhe zbatuar instrumentet mbështetës të zhvillimit rural në konsultim dhe me pjesëmarrjen e aktorëve vendor? A funksionojnë sisteme efektive të informimit dhe konsultimit? A krijojnë instrumentet publike mundësi për fuqizimin e rolit të qeverisjes vendore në zhvillimin rural? Po të aktorëve të tjerë?*

Informimi dhe konsultimi me të gjithë grupet target të skemave duhet të jetë pjesë e procesit të rishikimit dhe zbatimit të tyre. Transparenca përgjatë procesit është një nevojë sa institucionale aq edhe në lidhje me krijimin dhe mbajtjen e besimit të fermerëve dhe aktorëve të tjerë. Bashkitë si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve duhet të jenë aktorë të rëndësishëm dhe të nxitet roli aktiv i tyre në procesin e hartimit, promovimit dhe vendim-marrjes të skemave mbështetëse.

3

*A ka pronësi vendore në mekanizat dhe instrumentet mbështetës të zhvillimit rural? Cilat janë pritshmëritë e banorëve të komuniteteve rurale për këto programe?*

Vëmë theksin në rolin e qartë që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të ndërmarrë si institucioni kryesor në raport me ministrinë e linjës për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2014-2020, e prej këtej si pikënisje për pronësinë dhe lidhshërinë institucionale të çdo lloj programi që synon zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Qasja e integruar e sektorit duhet të përcillet në institucionet publike në nivel vendor.

Në vijim të kësaj, pronësia vendore duhet të forcohet, si mësimi kryesor që programe të mëparshme na kanë mësuar në lidhje me paqëndrueshmërinë e tyre pavarësisht synimit të mirë që kanë pasur. Programet e zhvillimit rural kanë nevojë për zërin e komuniteteve rurale. Zbatimi i qajses LEADER/CLLD (Zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti) do të garantonte mirë-menaxhimin e zhvillimit rural dhe rajonal.